

Përmbledhje

Eurozona është karakterizuar me rritje ekonomike prej 5.4 përqind në TM1 2022, megjithëse e ndodhur në përballje me presione të rritura inflacioniste si pasojë e ndërprerjeve të vazhdueshme në zingjirët furnizues që nga pandemia, dhe së fundmi, pasojave ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga fillimi i luftës në Ukrainë. Në reagim ndaj agresionit rus, vendet e BE-së kanë vendosur sanksione ekonomike dhe financiare ndaj Rusisë, gjë që është përkthyer në rritjen e çmimeve të ushqimit, gazit e naftës. Pasiguritë e ndërlidhura me gjendjen gjeopolitike dhe situatën e furnizimit me energji në eurozonë kanë presionuar BQE-në që të rishikoj parashikimet e indikatorëve kryesor makroekonomik. Në qershor 2022, BQE uli parashikimin për rritje ekonomike në 2.8 përqind për vitin 2022, nga 3.7 përqind sa ishte parashikimi i mars 2022, ndërsa parashikimin për inflacionin rriti në 6.8 përqind, nga 5.1 përqind sa ishte parashikimi paraprak.

Vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje të aktivitetit ekonomik prej 4.7 përqind në TM1 2022. Mali i Zi raportoi rritjen më të lartë të aktivitetit ekonomik prej 7.2 përqind, ndërsa Maqedonia e Veriut më të ulët prej 2.4 përqind. Përderisa rreziqet në lidhje me pandeminë janë zvogëluar, lufta në Ukrainë pritet të përkthehet në rritje më të ngadalësuar ekonomike. FMN-ja ka ulur parashikimin për vendet e Ballkanit Perëndimor nga 4.4 përqind në 2.9 përqind për vitin 2022.

Sipas vlerësimeve të ASK-së, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 4.9 përqind në TM1 2022, ndërsa për vitin 2022, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje prej 3.0 përqind. Ngadalësimi i rritjes së aktivitetit ekonomik pritet të jetë i ndikuar nga rritja më e ulët e kërkesës së brendshme. Lufta në Ukrainë ka ndikuar në rritjen e rreziqeve për perspektivën ekonomike dhe ndikimi i kësaj krize pritet të reflektohet në rritje të mëtejme të çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimit në muajt vijues të vitit, me efekte negative në besueshmërinë e konsumatorëve dhe fuqinë blerëse.

Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rikuperimit ekonomik në vitin 2021 dhe rritja relativisht e lartë e çmimeve globale të inputeve të ndërmjetme dhe energjisë, si pasojë e kombinimit të efekteve pandemike dhe luftës në Ukrainë, ka bërë që indeksi i çmimeve të konsumit të shënojë rritje prej 8.2 përqind në TM1 2022. Trendi i përsheptuar i rritjes së çmimeve pritet të vazhdojë dhe sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit për këtë vit pritet të jetë 11.0 përqind.

Aktiviteti ekonomik i shoqëruar me rritje të çmimeve rezultoi në rritje të ndikuar në rritje të konsiderueshme të të hyrave buxhetore në TM1 2022 (19.3 përqind), përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rënie prej 12.2

përqind, duke bërë që Buxheti i Kosovës të shënojë bilanc primar buxhetor prej 114.5 milionë euro. Borxhi publik ka shënuar rritje prej 9.7 përqind dhe ka arritur vlerën 1.68 miliardë euro, përderisa si përqindje e BPV-së, arriti në 20.3 përqind.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse shënoi rritje prej 126.5 përqind duke arritur në 344.6 milionë euro. Rritja e lartë e importit të mallrave përkeqësoi ndjeshëm bilancin e mallrave, përkundrazi rritjes që shënoi eksporti. Në anën tjetër, bilanci i shërbimeve dhe ai i të ardhurave dytësore janë përmirësuar në TM1 2022. Deficiti tregtar i mallrave është rritur për 34.9 përqind dhe ka arritur nivelin prej 939.7 milionë euro, ndërsa bilanci i shërbimeve shënoi rritje prej 21.3 përqind dhe arriti vlerën prej 174.0 milionë euro.

Zgjerimi më i ngadalësuar i aseteve të sistemit financiar krahasuar me vitin paraprak reflekton kryesisht zhvillimet në sektorin bankar, përkatësisht rritjen më të ngadalësuar të depozitave. Sektori bankar shënoi rritjen më të theksuar të kreditimit që nga viti 2009, duke mbështetur aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend. Bankat mbajtën nivel optimal të kapitalizimit, likuiditetit dhe cilësi të lartë të kredive edhe në tremujorin e parë të vitit 2022. Rritja e lartë të aktivitetit kreditor të sektorit bankar pas një viti me rritje më të ngadalësuar rezultoi në jetë mbështetur kryesisht nga kërkesa e rritur kreditorë, por edhe nga oferta e lehtësuar kreditorë. Depozitat, të cilat praqesin burimin kryesor të financimit të bankave, shënuan rritje më të ngadalësuar vjetore këtë periudhë. Ky ngadalësim mund t'i atribuohet deri në një masë presioneve inflacioniste dhe prospekteve për dinamikën në çmime në muajt në vijim. Sjellja e akterëve kryesor në treg, nën prospektet për përkeqësim të shkallës së inflacionit, rezultoi në jetë përkthyer në rritje të shfrytëzimit të depozitave nga dy segmentet (ekonomi familjare dhe ndërmarrje) dhe rritje të kërkesës për kredi (financim i kapitalit të punës dhe rritje e stokeve nga bizneset; blerje e patundshmërive nga ekonomitë familjare).

Sektori pensional gjatë këtij tremujori shënoi rritje të aktivitetit, mbështetur nga kontributet e arkëtura prej kontributdhënësve si dhe kthimit në investime të realizuar në vitin e kaluar. Gjatë këtij tremujori, sektori pensional realizoi kthim negativ në investime për shkak të efekteve negative të luftës në Ukrainë në tregjet financiare ndërkombëtare. Sektori i sigurimeve u zgjerua si rrjedhojë e nivelit më të lartë të primeve të shkruara krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë, përderisa dëmet e paguara mbetën pothuajse në nivel të ngjashëm me periudhën paraprake (rënie marxhinale). Rritja e sektorit mikrofinanciar u mundësua kryesisht nga huazimet prej institucioneve financiare (kryesisht jashtë vendit), që financuan aktivitetin e lizingjeve dhe atë kreditor për ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	6
Ekonomia e Kosovës	7
Sektori Real	7
Çmimet	8
Sektori Fiskal	9
Sektori i Jashtëm	10
Kuti informuese: Importi dhe eksporti i mallrave të Kosovës	12
Sistemi Financiar	18
1. Sektori Bankar	18
1.1. Bilanci i gjendjes - Asetet	19
Kuti informuese	26
Sektori pensional	28
Sektori i sigurimeve	29
Performanca e sektorit të sigurimeve	31
Sektori mikrofinanciar	31
Asetet	31
Performanca e sektorit mikrofinanciar	33
Tregu i letrave me vlerë	34

GRAFIKËT DHE TABELAT

Grafik 1. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë -----	07
Grafik 2. Inflacioni i përgjithshëm -----	08
Grafik 3. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj -----	10
Grafik 4. Eksporti dhe importi i mallrave -----	10
Grafik 5. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave -----	10
Grafik 6. Kategoritë kryesore të importit të mallrave -----	11
Grafik 7. Remitencat -----	11
Grafik 8. Struktura e investimeve të huaja direkte -----	12
Grafik 09. Vlera e aseteve e sistemit financiar të Kosovës -----	18
Grafik 10. Koncentrimi në asetet e sistemit financiar -----	18
Grafik 11. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar -----	19
Grafik 12. Stoku i gjithsej kredive -----	20
Grafik 13. Kreditë e reja -----	20
Grafik 14. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo financiare -----	21
Grafik 15. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare -----	21
Grafik 16. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar -----	21
Grafik 17. Stoku i gjithsej depozitave -----	22
Grafik 18. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave -----	22
Grafik 19. Depozitat e reja -----	22
Grafik 20. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore -----	23
Grafik 21. Norma e interesit në kredi deh depozita -----	23
Grafik 22. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare -----	24
Grafik 23. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare -----	24
Grafik 24. Norma e interesit për depozita -----	24
Grafik 25. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	25
Grafik 26. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione -----	25
Grafik 27. Treguesit e solvencës -----	26
Grafik 28. Treguesit e likuiditetit -----	26
Grafik 29. Asetet e sektorit pensional -----	28
Grafik 30. Struktura e aseteve të FKPK-së -----	28
Grafik 31. Struktura e aseteve të FSKP-së -----	29
Grafik 32. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së -----	29
Grafik 33. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	30
Grafik 34. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	30
Grafik 35. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	31
Grafik 36. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare -----	32
Grafik 37. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë -----	32

Grafik 38. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	32
Grafik 39. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	33
Grafik 40. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	33
Grafik 41. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar-----	33
Grafik 42. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	34
Grafik 43. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore-----	34
Grafik 44. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar -----	34
Grafik 45. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	35
Grafik 46. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	35
Tabela 1. Kontributi i kategorive specifike dhe gjithsej inflacionin -----	08
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	37

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
ËEO	Ëorld Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Dinamikat pozitive makroekonomike që karakterizuan vitin 2021 vijuan edhe në TM1 2022, kur eurozona rezultoi të ketë shënuar një rritje reale të BPV-së prej 5.4 përqind, megjithë presionet e rritura inflacioniste si pasojë e pengesave evidente në zinxhirët furnizues dhe presionet mbi çmimet e energjisë dhe mallrave të tjera. Fillimi i luftës në Ukrainë në fund të muajit shkurt shkaktoi sfida të reja ekonomike, reflektuar në formë të presioneve të rritura inflacioniste dhe rënies së besueshmërisë së konsumatorëve. Rëndimi i situatës gjeopolitike dhe pasigurisë rreth ecurisë së luftës, si dhe pasojat ekonomike që ndërlikohen me sanksionet ekonomike e financiare të vendosura ndaj Ruisë, kanë ndikuar negativisht prospektet mbi aktivitetin ekonomik për këtë vit. Projektioni i BQE-së për rritjen reale të BPV-së, i realizuar në qershor 2022, është ulur në 2.8 përqind për vitin 2022, nga 3.7 përqind sa ishte në mars 2022.

Dinamikat në çmime përcollën trend rritës edhe gjatë TM1 2022, duke u reflektuar kështu në normën më të lartë të inflacionit të shënuar në dekadën e fundit prej 6.1 përqind. Pengesat evidente në zinxhirët prodhues si pasojë e pandemisë, shoqëruar me rritje të theksuar të kërkesës me rihapjen e ekonomive në vitin 2021 që u mbështet fuqishëm nga pakot fiskale e monetare të qeverive, ka shkaktuar presion në rritje të çmimeve të produkteve dhe kostove të prodhimit. Inflacioni në rritje u intensifikua tutje me fillimin e luftës në

Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj Ruisë. Efektet pasuese në rritjen e mëtejme të çmimeve të produkteve ushqimore, gazit dhe naftës dhe rrjedhimisht kostove të energjisë, rënduan më tej situatën në eurozonë, konsideruar varësinë e lartë të eurozonës nga furnizimi me gazin rus.

Në një mjedis me pasiguri të konsiderueshme rreth zhvillimeve gjeopolitike dhe situatës me inflacionin për pasojë, Këshilli Drejtues i BQE-së vendosi të mbajë politikë monetare fleksibile duke i mbajtur opsionet e hapura varësisht se si zhvillohet ekonomia, përdërisa komunikoi pritjet për përfundimin e programit të blerjeve të neto aseteve në tremujorin e tretë. Për vitin 2022, BQE ka parashikuar normë të inflacionit prej 6.8 përqind, normë që pritet të normalizohet në dy vitet vijuese në 3.5 përkatësisht 2.1 përqind, nën skenarin bazë.¹

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 3.5 përqind në TM1 2022, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 4.5 përqind. Në anën tjetër, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 6.5 përqind, ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 4.0 përqind.

Vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje të aktivitetit ekonomik prej 4.7 përqind në TM1 2022. Të gjitha vendet shënuan rritje të aktivitetit ekonomik, ndërsa rritja më e lartë është shënuar në Mal të Zi (7.2 përqind) dhe më e ulëta në Maqedoni të Veriut (2.4 përqind). Si rezultat i luftës në Ukrainë, FMN-ja ka

¹ Përveç skenarit bazë është realizuar edhe skenari negativ, i cili supozon se lufta në Ukrainë do të jetë më intensive dhe më e zgjatur sesa në skenarin bazë, duke u shtrirë edhe në vitin

2023. Skenari negativ paraqet një situatë më të rëndë ku rritja ekonomike do të ishte më e ngadalësuar në vitin 2022 (1.3 përqind) dhe presionet inflacioniste do të ishin më të larta (6.4 përqind).

ulur parashikimin për vendet e Ballkanit Perëndimor nga 4.4 përqind në 2.9 përqind për vitin 2022.

Ngritje e shkallës së inflacionit u raportua edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë e rritjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Shkalla mesatare e inflacionit në TM1 2022 ishte 7.2 përqind, ku Serbia dhe Kosova regjistruan shkallën më të lartë të rritjes së inflacionit prej 8.7 përkatësisht 8.2 përqind.

Vendet e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje të aktivitetit kreditues prej 11.4 përqind. Norma më e lartë e rritjes ishte në Kosovë (18.4 përqind) dhe Shqipëri (11.9 përqind) ndërsa më e ulëta në Mal të Zi (5.4 përqind). Depozitat shënuan rritje prej 10.4 përqind, që është normë më e ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Norma më e lartë e rritjes së depozitave është shënuar në Mal të Zi (23.8 përqind) dhe Shqipëri (9.4 përqind) ndërsa më e ulëta në Maqedoni të Veriut (3.5 përqind).

Gjatë TM1 2022, valuta euro është vlerësuar ndaj lirës turke (75.8 përqind), denarit maqedonas (0.1 përqind), ndërsa ka mbetur e pandryshuar ndaj dinarit serb, dhe është zhvlerësuar ndaj dollarit amerikan (6.9 përqind), frankës zvicerane (4.9 përqind), sterlinës britanike (4.4 përqind), lekut shqiptar (1.3 përqind), etj.

Ekonomia e Kosovës


Sektori Real

Sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 10.5 përqind në vitin 2021 (-5.3 përqind në vitin 2020). Rritja e lartë e aktivitetit ekonomik i'u atribuua rritjes së të hyrave nga diaspora, me përmirësimin e dinamikave pandemike dhe lehtësimit të masave

kufizuese si rrjedhojë, si dhe politikave stimuluese fiskale e financiare. Të hyrat nga diaspora (remitencat, shpenzimet e udhëtimit dhe investimet në patundshmëri) rezultojnë të kenë pasur një pjesëmarrje të lartë në gjithsej BPV-në e gjeneruar në vend prej rreth 39 përqind në vitin 2021.

ASK sugjeron se gjatë TM1 2022 është shënuar rritje e aktivitetit ekonomik prej 4.9 përqind. Konsumi dhe investimet kontribuan pozitivisht me 9.6 përkatësisht 1.4 pikë përqindje, ndërsa eksportet neto kishin një kontribut negativ prej 6.2 pikë përqindje (grafik 1).

Grafik 1. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Rritja më e lartë e BPV-së reale në TM1 2022, sipas ASK-së, është shënuar në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (8.8 përqind), tregtisë (8.6 përqind), industrisë përpunuese (5.4 përqind), etj. Aktiviteti i shtuar ekonomik në këtë tremujor rezultoi të jetë mbështetur në masë të madhe nga kreditimi i sektorit bankar.

Sa i përket vitit 2022, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje më të ngadalësuar prej rreth 3.0 përqind. Ngadalësimi i rritjes së aktivitetit ekonomik pritet të jetë kryesisht

pajisjeve për transportin personal (23.8 përqind), pastaj blerja e automjeteve (5.6 përqind), si dhe shërbimet për transport (5.5 përqind).

Çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse në TM1 2022 shënuan rritje prej 16.1 përqind. Kjo rritje e çmimeve të energjisë është rezultat i krizës energjetike, e shkaktuar nga çmimet e larta të energjisë në tregun ndërkombëtar por edhe rritjes së konsumit gjatë kësaj periudhe, pasi që një pjesë e madhe e energjisë përdoret për ngrohje.

Trendi i përshpejtuar i rritjes së çmimeve pritet të vazhdoj edhe në pjesën tjetër të vitit 2022 dhe sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit në vitin 2022 pritet të jetë 11.0 përqind. Të ngjashme me parashikimet e BQK-së janë edhe pritjet e bankave, të cilat kanë deklaruar se presin që niveli i inflacionit do të jetë në rritje.

Sektori Fiskal

Sektori fiskal gjatë TM1 2022 është karakterizuar me rritje të të hyrave buxhetore dhe rënie të shpenzimeve buxhetore, duke bërë që bilanci buxhetor të jetë pozitiv. Të hyrat buxhetore² arritën vlerën neto 542.6 milionë euro (19.3 përqind rritje), përderisa shpenzimet buxhetore³ arritën vlerën 428.1 milionë euro (12.2 përqind rënie). Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 114.5 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Aktiviteti ekonomik i shoqëruar me rritje të çmimeve ka ndikuar që tatimet direkte të arrijnë vlerën prej 100.0 milionë euro në TM1 2022 apo 31.9 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021. Si rezultat i kësaj rritje, është rritur edhe pjesëmarrja e tatimeve direkte

në gjithsej të hyrat buxhetore nga 16.7 përqind sa ishte në TM1 2021 në 18.4 përqind në TM1 2022. Tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje prej 80.4 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje prej 14.1 përqind. Rritja e çmimeve ka ndikuar në rritjen e vlerës së importit të mallrave dhe kjo ka ndikuar në rritjen e të hyrave tatimore indirekte prej 16.9 përqind. Në TM1 2022, të hyrat tatimore indirekte shënuan vlerën 393.0 milionë euro dhe përbëjnë 72.4 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore. TVSH-ja dhe akciza si dy kategoritë kryesore të tatimeve indirekte shënuan rritje prej 23.0 përkatësisht 5.6 përqind.

Sa i përket shpenzimeve, kategoria kryesore që kontribuoi në rënien e shpenzimeve buxhetore ishin shpenzimet kapitale, të cilat në TM1 2022 ishin vetëm 28.0 milionë euro apo 51.6 përqind më të ulëta krahasuar me TM1 2021. Gjatë këtij tremujori, shpenzimet kapitale përbënin vetëm 6.5 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore (11.9 përqind në TM1 2021). Edhe shpenzimet rrjedhëse shënuan rënie prej 6.9 përqind dhe arritën vlerën 400.1 milionë euro. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rënie prej 13.0 përqind dhe arritën vlerën 171.1 milionë euro. Shpenzimet për paga shënuan rënie prej 6.3 përqind dhe arritën vlerën 164.2 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 11.9 përqind dhe arritën vlerën 64.8 milionë euro.

Borxhi publik në TM1 2022 ka arritur në 1.68 miliardë euro, që është për 9.7 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2021. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka rënë

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi.


³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

në 20.3 përqind nga 21.8 përqind sa ishte në TM1 2021. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm publik për 10.3 përqind (që ka arritur në 1.12 miliardë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 8.6 përqind (që ka arritur në 561.3 milionë euro). Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind e BPV-së, rrjedhimisht niveli i borxhit publik prej 20.3 përqind e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit.

Sektori i Jashtëm

Deficiti i llogarisë rrjedhëse shënoi rritje prej 126.5 përqind duke arritur në 344.6 milionë euro. Rritja e lartë e importit të mallrave përkeqësoi bilancin e mallrave, përkundër rritjes që shënoi eksporti. Në anën tjetër, bilanci i shërbimeve dhe ai i të ardhurave dytësore janë përmirësuar në TM1 2022 (grafik 3).


Grafik 3. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK.

Eksporti i mallrave në TM1 2022 është rritur për 42.7 përqind ndërkohë që importi është rritur për 35.5 përqind. Baza e lartë dhe rritja e theksuar e importit ka ndikuar që deficiti tregtar i mallrave të rritet për 34.1 përqind duke arritur nivelin prej 1.0 miliardë euro (grafik 4).


Grafik 4. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Vlera e eksportit të mallrave gjatë TM1 2022 ishte 218.1 milionë euro dhe rritja më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është shënuar tek produktet minerale, produktet e plastikës, pastaj ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, etj. (grafik 5).


Grafik 5. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Vlera e importit të mallrave gjatë TM1 2022 ishte 1.2 miliardë euro, që paraqet rritje prej 35.5 përqind. Pothuajse të gjitha kategoritë e importit kanë shënuar rritje, ndërkohë që rritjen më të lartë e ka shënuar importi i produkteve minerale, pastaj metalet bazë, makineritë dhe pajisjet elektrike, ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, etj. (grafik 6).

Grafik 6. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.


Me zbutjen dhe eliminimin e masave kufizuese, edhe tregtia me shërbime ka vazhduar të rritet në TM1 2022. Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 174.0 milionë euro, nga 143.4 milionë euro sa ishte në TM1 2021.

Vlera e eksportit të shërbimeve arriti në 375.6 milionë euro, nga 284.3 milionë euro sa ishte në TM1 2021. Rritjen më të lartë e shënuan eksporti i shërbimeve të udhëtimit dhe shërbimeve kompjuterike. Eksporti i shërbimeve të udhëtimit në këtë tremujor arriti vlerën prej 258.2 milionë euro (181.4 milionë euro në TM1 2021). Edhe importi i shërbimeve ka shënuar rritje në TM1 2022, ku vlera e shërbimeve të importuara ishte 201.6 milionë euro (140.8 milionë euro në TM1 2021). Tek importi i shërbimeve, rritja më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve të transportit dhe udhëtimit.

Llogaria e të ardhurave parësore shënoi rënie për 8.0 përqind në TM1 2022, pasi që të ardhurat nga investimet në Kosovë ishin më të larta. Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve jashtë Kosovës shënuan një rritje prej 1.7 përqind, ndërsa remitencat shënuan një rënie të lehtë. Për dallim nga tremujorët paraprak të vitit 2021 kur ishte shënuar rritje e lartë e

remitencave, në TM1 2022 niveli i remitencave ishte 241.4 milionë euro, apo 0.6 përqind më pak krahasuar me TM1 2021 (grafik 7).

Grafik 7. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK.

Sa i përket kanaleve të transferimit, 63.5 përqind e remitencave kanë ardhur përmes agjencive për transferim të mjeteve, të cilat shënuan rritje prej 3.0 përqind. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 25.4 përqind dhe përbëjnë 17.4 përqind të gjithëj remitencave të pranuar në TM1 2022. Remitencat përmes kanalit 'jo-formal' shënuan rënie për 24.1 përqind dhe përbëjnë 19.1 përqind të gjithëj remitencave. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, me 40.0 përkatësisht 18.5 përqind të gjithëj remitencave në TM1 2022. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të (8.0 përqind).

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në TM1 2022 kanë arritur vlerën prej 147.4 milionë euro apo 42.1 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione ishte 128.2 milionë euro apo 38.2 përqind më shumë, ndërsa instrumentet e borxhit ishin 19.3 milionë euro apo 75.1 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021 (grafik 8).

Grafik 8. Struktura e investimeve të huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK.


Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e patundshmërive (75.8 përqind rritje), ku pjesëmarrja e

këtij sektori në gjithsej IHD-të arriti në 95.8 përqind nga 61.2 përqind sa ishte në TM1 2021. Një rritje kaq e lartë e investimeve në patundshmëri mund t'i atribuohet edhe rritjes së inflacionit dhe zhvlerësimit të valutës euro, ku investitorë të ndryshëm janë ndjerë më të sigurt nga investimi në patundshmëri. Rritja e investimeve në patundshmëri vërehet edhe nga rritja e kredive hipotekare prej 53.2 përqind në TM1 2022. Përveç investimeve në patundshmëri, IHD-të kanë shënuar rritje edhe në sektorin e xehetarisë, prodhimit, etj., ndërsa në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit, furnizimit me energji, etj. është shënuar rënie e IHD-ve.

Kuti informuese: Importi dhe eksporti i mallrave të Kosovës

Një ndër problemet strukturore të modelit ekonomik të Kosovës është deficitin i lartë tregtar i mallrave. Eksportet mbulojnë vetëm rreth 17 përqind të importeve (grafik 1) (rreth 58 përqind në Shqipëri, 95 përqind në Eurozonë). Me rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në ekonomi, mbulueshmëria e importeve me eksporte është përmirësuar gradualisht, ndonëse me ritëm të ulët.

Grafik 1. Vlera e eksporteve dhe importeve




Burimi: Dogana e Kosovës.

Në TM1 2022, niveli i importit të mallrave arriti në 1.24 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 35.5 përqind. Rritja e theksuar e vlerës së importit të mallrave gjatë TM1 2022 kryesisht i është atribuuar rritjes së lartë të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, mbështetur edhe nga evidentimi i rritjes së importit të mallrave të konsumit prej 15.0 përqind.


Kategoritë kryesore të importit, produktet minerale dhe metalet bazë, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 20.3 përkatësisht 10.6 përqind në gjithsej importin, shënuan rritjen më të lartë të importit (127.4 përkatësisht 48.7 përqind) (grafik 2). Rritja e lartë e këtyre kategorive kryesisht i'u atribuua rritjes së çmimeve të naftës së papërpunuar prej 62.9 përqind, si dhe rritjes së çmimeve të metaleve bazë prej 34.5 përqind në TM1 2022.

Grafik 2. Importet, sipas kategorive kryesore



Sa i përket importit sipas vendeve, vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s janë vendet prej nga Kosova importon pjesën më të madhe të mallrave. Në TM1 2022, Kosova importoi 45.0 përqind të gjithsej mallrave nga vendet e BE-së apo 25.8 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021, si dhe 17.0 përqind të gjithsej importeve nga vendet e CEFTA-s apo 34.8 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021 (grafik 3).

Grafik 3. Importi i mallrave, vendet kryesore importuese




Sa i përket vendeve në veçanti, Gjermania në vitet e fundit kishte pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej importin e mallrave, ndërsa këtë tremujor, rezultoi të

jetë tejkaluar nga Turqia. Një pjesë e madhe e importit të mallrave është realizuar edhe nga Kina dhe Sllovenia (9.8 përkatësisht 8.8 përqind e gjithsej importeve). Kosova importoi nga Sllovenia kryesisht energji elektrike këtë tremujor, dinamikë që u shprehë më pas në çmime më të larta të energjisë për konsumatorët kosovar. Niveli i ulët i importeve nga Serbia në TM1 2019 & TM1 2020, ilustruar në figurën 2, kryesisht reflekton embargon për mallrat e importuara nga ky vend gjatë asaj periudhe.

Nëse analizojmë importin e mallrave kryesore sipas vendit të origjinës, në TM1 2022 rezultoi se Arabia Saudite prinë në importin e lëndëve djegëse, pasuar nga Maqedonia e Veriut, Greqia, etj. Energjia elektrike kryesisht importohet nga Sllovenia, pasuar nga Danimarka dhe Shqipëria. Importi më i madh i shufrave të çelikut është realizuar nga Shqipëria, ndërkohë që cigaret si vend origjine kanë Poloninë, Gjermaninë, Turqinë, Zvicrën, etj.


Përderisa struktura e përgjithshme e importeve, sipas vendeve të origjinës, ka mbetur kryesisht e pandryshuar ndër vite, lufta në Ukrainë mund të shkaktoj ndryshim të dinamikave në tregjet ndërkombëtare. Lëvizjet drejtë tregjeve tjera, si pasojë e ndryshimit të dinamikave të përgjithshme makroekonomike në nivel global, shoqërohet me rritje të kostove për vendet importuese, duke u reflektuar në rritje të çmimeve – me efekte potenciale si në rritje të ngarkesës me borxh ashtu edhe të rënies potenciale të kërkesës.

Grafik 4. Vendet kryesore importuese të lëndëve djegëse




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 5. Vendet kryesore importuese të energjisë elektrike




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 6. Vendet kryesore importuese të shufrave të çelikut



Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 7. Vendet kryesore importuese të cigareve



Burimi: Dogana e Kosovës.

Nga figura 8-11 është paraqitur importi i mallrave esenciale sipas vendit të origjinës. Historikisht, Kosova rezulton të ketë importuar grurin kryesisht nga Hungaria, ndërkohë që në TM1 2022, importet e grurit kryesisht kanë origjinuar nga Serbia. Kjo dinamikë mund t'i atribuohet kryesisht faktit se në këtë tremujor, Hungaria ka vendosur masa kufizuese sa i përket eksportit të grurit jashtë vendit. Franca prinë sa i përket importit të sheqerit të bardhë, Serbia vajit ushqimor dhe Sllovenia qumështit.⁴

Eksporti i mallrave ka shënuar rritje prej 42.7 përqind, duke arritur vlerën 218.1 milionë euro. Edhe tek


eksporti, pothuajse të gjitha kategoritë kanë shënuar rritje të çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Çmimet e metaleve dhe mineraleve në TM1 2022 shënuan rritje prej 24.5 përqind dhe kjo ka ndikuar në dyfishimin e eksportit të mineraleve. Gjithashtu, indeksi i çmimeve të ushqimit ka shënuar rritje prej 24.7 përqind ndërkohë që rritja e eksportit të ushqimeve të përgatitura ishte 28.6 përqind (grafik 12).

Sa i përket eksportit sipas vendeve, Kosova kryesisht eksporton në vendet fqinje dhe vendet ku është e


⁴ Referojuni grafikëve në apendiks për më shumë detaje lidhur me çmimet e importit të produkteve esenciale

Grafik 8. Vendet kryesore importuese të grurit




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 9. Vendet kryesore importuese të sheqerit të bardhë




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 10. Vendet kryesore importuese të vajit ushqimor




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 11. Vendet kryesore importuese të qumshtit



Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 12. Eksportet, sipas kategorive kryesore



Burimi: Dogana e Kosovës.


vendet e CEFTA-s gjatë TM1 2022 ishte 71.9 milionë euro, një rritje prej 32.2 përqind, ndërsa eksporti i mallrave në vendet e BE-së ishte 70.7 milionë euro apo 37.1 përqind më shumë krahasuar me TM1 2021. Në vitet e fundit Shqipëria, Gjermania dhe Maqedonia e Veriut ishin destinacionet kryesore të eksportit, por që në vitin e fundit janë tejkaluar nga eksporti në SHBA (grafik 13).

Eksporti drejt SHBA-së ka vazhduar të karakterizohet me trend të lartë rritës, ku në TM1 2022, niveli i eksportit të mallrave në SHBA ishte 48.0 milionë euro (22.0 milionë euro në TM1 2021), duke bërë që pjesëmarrja e SHBA-ve në gjithsej eksportin e

koncentruar diaspora kosovare. Eksporti i mallrave në vendet e CEFTA-s ka një pjesëmarrje prej 33.0 përqind ndërsa në vendet e BE-së 32.4 përqind. Eksporti në


mallrave të arrijë në 22.0 përqind nga 14.4 përqind sa ishte në TM1 2021.

Grafik 13. Eksporti i mallrave, vendet kryesore eksportuese




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 14. Vendet kryesore eksportuese të dyshekëve



Burimi: Dogana e Kosovës.


Grafik 16. Vendet kryesore eksportuese të ferro-nikel



Burimi: Dogana e Kosovës.


Në figurat 14-17 janë të paraqitura produktet kryesore të eksportuara sipas vendeve, që dëshmojnë për shkallë të lartë të koncentrimit - eksporti i mallrave kryesore realizohet në një numër të vogël të vendeve. Rritja e lartë e eksporteve në dy vitet e fundit ishte kryesisht si rezultat i rritjes së eksportit të dyshekëve në SHBA. Sa i përket eksportit të energjisë elektrike, ngjashëm me importin, prinë Sllovenia, pasuar nga Danimarka, Çekia etj. Xehëroret e nikelit kryesisht eksportohen në vendet e rajonit, kurse xehëroret tjera në Mal të Zi, Bullgari dhe Zvicër.

Grafik 15. Vendet kryesore eksportuese të energjisë elektrike



Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 17. Vendet kryesore eksportuese të xehërore



Burimi: Dogana e Kosovës.

Në dy tabelat më poshtë, për qëllime informuese janë të paraqitura në grafikë, vlera e mallit të importuar/eksportuar sipas vendeve, dhe peshës që zënë secili vend në gjithsej importet/eksportet.

Tabela 1. Eksportet e Kosovës (sipas shteteve), në milionë euro






Tabela 2. Importet, sipas vendit të origjinës (në milionë euro)



Sistemi Financiar

Sistemi financiar vazhdoi trendin pozitiv të rritjes, mirëpo me një ritëm dukshëm më të ngadalshëm krahasuar me periudhën paraprake. Dinamikat në sistemin financiar gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 u përcaktuan kryesisht nga ngadalësimi i rritjes së depozitave, ndërkohë që kreditimi shënoi rritje të theksuar. Sektori pensional kontribuoi pozitivisht në rritjen e asetëve të sistemit financiar, mbështetur kryesisht në arkëtimet nga kontribut-dhënësit, ndërkohë që trazimi i tregjeve financiare me fillimin e luftës në Ukrainë u shoqërua me kthim negativ në investimet e sektorit. Sektorët tjerë kishin kontribut pozitiv në rritje, por pesha e tyre në sistem vazhdon të jetë e ulët.

Grafik 09. Vlera e asetëve e sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK.

Në fund të marsit 2022, asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 8.80 miliardë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 9.1 përqind (12.4 përqind një vit më parë) (grafik 09). Sektori bankar shënoi ngadalësim të rritjes krahasuar me periudhën paraprake, që reflekton kryesisht ecurinë e depozitave, të cilat shënuan rritje më të ulët se një vit më parë. Sektori

pensional, si sektori i dytë për nga pesha në kuadër të sistemit financiar (grafik 10), shënoi rritje të përshpejtuar vjetore të asetëve, e ndikuar nga kthimi në investime gjatë tremujorit të parë të vitit 2022. Humbjet e realizuara nga investimet gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 kufizuan rritjen e asetëve të sektorit.

Sektori mikrofinanciar shënoi rritje të përshpejtuar krahasuar me një vit më parë, si rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues, mbështetur kryesisht nga financimi nga sektori i jashtëm. Sektori i sigurimeve vazhdoi trendin e rritjes së dy viteve të kaluara, e që reflekton kryesisht kontributin e rritjes së primeve të shkruara bruto përgjatë kësaj periudhe.

Grafik 10. Koncentrimi në asetet e sistemit financiar, sipas sektorëve përbërës




Burimi: BQK.

1. Sektori Bankar

Në përgjithësi, sektori bankar vazhdon të operoj në një ambient me nivel të ulët të kredive me probleme, likuiditet optimal dhe është mirë i kapitalizuar. Sektori bankar gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të theksuar të kreditimit, mbështetur nga rritja e kërkesës për kredi, financiar përmes depozitave. Këto dinamika u përkthyen në rritje rekorde të fitimit të realizuar.

1.1. Bilanci i gjendjes - Asetet

Rritja e aseteve të sektorit bankar u ngadalësua, pas tri vitesh të rritjes së përshpejtuar, duke reflektuar kryesisht ecurinë e arkëtimit të depozitave. Në mars 2022, gjithsej asetet e sektorit bankar arritën vlerën në 5.82 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.9 përqind (grafik 11). Struktura e aseteve vazhdon të mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku kreditë që kanë peshën më të madhe në kuadër të aseteve (67.5 përqind), pasuar nga ajo e parasë së gatshme (12.2 përqind), letrave me vlerë (10.5 përqind), dhe mjeteve të mbajtura në bankat tjera komerciale (6.7 përqind) e që kryesisht janë jashtë vendit.



Burimi: BQK.

Struktura e letrave me vlerë vazhdon të dominohet nga investimet në bono dhe fletëobligacione qeveritare (vendore dhe të huaja), por në tri vitet e fundit kemi rritje të konsiderueshme të investimeve në letra me vlerë jo-qeveritare, të cilat kanë kthim më të lartë. Pesha e investimeve në letrat me vlerë jo-qeveritare në fund të marsit 2022 ishte 10.9 përqind krahasuar me peshën, prej 4.1 përqind të gjithsej investimeve në letrat me vlerë në mars 2019. Letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës dominojnë strukturën e gjithsej letrave me vlerë (46.5 përqind) pasuar nga ato të


qeverive të huaja (42.6 përqind). Në periudhën raportuese është shënuar rënie e investimeve në letrat me vlerë, si në ato vendore (rënie vjetore prej 2.8 përqind) ashtu edhe të huaja (rënie vjetore prej 7.4 përqind). Tkurrja e investimeve në instrumentin e letrave me vlerë në masë të madhe reflekton rialokimin e mjeteve drejt aktivitetit kreditues. Ngjashëm me zhvillimet në letrat me vlerë, sektori bankar zvogëloi nivelin e ekspozimit me bankat dhe institucionet tjera financiare, e që kryesisht janë të mbajtura jashtë vendit në formë të depozitave të afatizuara dhe llogari rrjedhëse.

1.1.1 Aktiviteti kredidhënës

Aktiviteti kredidhënës shënoi rritje të përshpejtuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke kompensuar ngadalësimin e rritjes së dy periudhave paraprake, e që ndër tjerash u ndikua nga përhapja e pandemisë Covid 19. Në mars 2022, gjithsej kreditë arritën në 3.93 miliard euro, një rritje vjetore 18.4 përqind (7.7 përqind në periudhën paraprake). Në këtë rritje kontribuuan si sektori i ekonomive familjare, që shënoi rritjen më të lartë vjetore, ashtu edhe sektori i korporatave jofinanciare, që njëherësh kishte kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kredive. Rritja e përshpejtuar e kreditimit ndaj ekonomive familjare dhe sektorit të ndërmarrjeve kryesisht i është atribuar rritjes së kërkesës kreditore, mbështetur nga rritja e përgjithshme e kërkesës së brendshme dhe të hyrave të përgjithshme në ekonomi (të hyrave me bazë nga diaspora). Po ashtu, në nivel më të ulët, kreditimi u mbështet edhe nga oferta kreditore, mbështetur në prospektet pozitive makroekonomike pas normalizimit të gjendjes me

pandeminë Covid-19 dhe rimëkëmbjes së fuqishme ekonomike gjatë vitit 2021.

Grafik 12. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Po ashtu, edhe kreditë e reja gjatë periudhës janar-mars 2022 shënuan rritje të theksuar vjetore kundrejt rënies së shënuar në periudhën e njëjtë të vitit 2021 (grafik 13). Rritja më e lartë në kuadër të kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar është evidentuar tek sektori i korporatave jofinanciare, kreditimi ndaj të cilave u rrit për 75.9 përqind. Në rritje të kredive të reja gjatë TM1 2022, ndikimin më të lartë kishin ecuria e kredive të reja me qëllim investues, të cilat u dyfishuan në vlerë krahasuar me vitin paraprak, duke arritur në 297.4 milionë euro në fund të TM1 2022. Po ashtu, edhe kreditë e reja me qëllim jinvestues shënuan rritje të konsiderueshme (rritje për 42.2 përqind), dhe arritën vlerën prej 111.6 milionë euro në fund të TM1 2022. Pra, rritja e kreditimit për korporatat jo-financiare, veçanërisht atyre me qëllim investimi i është paraprirë inflacionit në rritje, që bizneset të akumulojnë kapital punues dhe rezerva të mallit me çmime aktuale, që të dëmtohen sa pak nga kostoja në rritje e produkteve bazë me të cilat ato punojnë.

Kontributin kryesor në rritjen e kredive të reja ndaj ekonomive familjare gjatë kësaj periudhe për herë të parë kishin kreditë hipotekare. Këto kredi për të dytin vit me radhë shënuan rritje të theksuar, dhe arritën vlerën prej 65.8 milionë euro vetëm në TM1 2022, që paraqet një rritje vjetore prej 53.2 përqind. Në rritje të theksuar të kredive hipotekare ka ndikuar ofrimi i kushteve më të favorshme nga bankat për këtë kategori, përmes uljes së kërkesës për kolateral, normës më të ulët të interesit, rritjes së shumës së aprovuar, si dhe zgjatjes së afatit të maturitetit. Për më tepër, fillimi i pajisjes me dokumentacion të rregullt të patundshmërive ka ndikuar që bankat të kenë fokus më të lartë në dhënie të kredive rezidenciale, kundrejt kolateralit të patundshmërisë. Ekonomitë familjare në anën tjetër rezultojnë të kenë rritur investimin në patundshmëri gjatë kësaj periudhe, si rezultat i ofrimit të kushteve më të favorshme nga bankat për këto kredi, pritjeve për rritje të mëtejme të çmimeve në patundshmëri në muajt në vijim, dhe nivelit të ulët të normave të interesit në depozitat e afatizuara.

Grafik 13. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Gjatë këtij tremujori, kreditë me qëllim konsumi shënuan rritje dukshëm më të ngadalësuar në

krahasim me vitin e kaluar dhe trendin e përgjithshëm. Këto kredi shënuan rritje vjetore prej 3.8 përqind në TM1 2022 (20.4 përqind në TM1 2021). Kreditë me qëllim konsumi vazhdojnë të kenë peshën më të madhe në kuadër të kredive të reja ndaj ekonomive familjare, prej 60.2 përqind. Gjatë TM1 2022, vlera e kredive të reja për qëllim konsumi arriti në 210.8 milionë euro.


Grafik 14. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jofinanciare



Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare vazhdon të dominohet prej sektorit të tregtisë, pasuar nga ai i prodhimtarisë dhe ndërtimtarisë, përderisa sektori i bujqësisë vazhdon të ketë peshën më të ulët (grafik 14).

Kreditë ndaj sektorit të tregtisë u rritën për 11.5 përqind (12.1 përqind në mars 2021) dhe kishin kontributin e dytë më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit të korporatave jofinanciare. Kurse, kreditimi ndaj sektorit të prodhimtarisë shënoi rritje të theksuar gjatë kësaj periudhe (47.1 përqind nga 23.3 përqind në mars 2021) dhe kishte kontributin kryesor në rritjen e kredive të korporatave jofinanciare. Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë për të dytin vit me radhë shënoi rënie, por e cila ishte më e ulët (rënie për 13.7 përqind) krahasuar me rënien e një viti më parë (prej 17.7 përqind) (grafik 15).


Grafik 15. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



1.2 Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar është tradicionale dhe përbëhet kryesisht nga depozitat (81.5 përqind), burimet vetanake (11.3 përqind), dhe obligimeve tjera (3.9 përqind). Historikisht, depozitat kanë paraqitur një burim të sigurt financues dhe me kosto mjaft të ulët për sektorin.


Grafik 16. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar - detyrimet dhe ekuiteti



1.2.1 Depozitat

Vlera e depozitave të mbajtura nga sektori bankar në fund të vitit 2021 arriti në 4.75 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.3 përqind (grafik 17 dhe 18).

Grafik 17. Stoku i gjithsej depozitave




Burimi: BQK.

Depozitat e arkëtuara prej ekonomive familjare vazhdojnë të kenë kontributin kryesor në rritje të gjithsej depozitave, pasuar nga depozitat e arkëtuara prej korporatave jofinanciare.

Depozitat e korporatave tjera financiare (kryesisht fondet pensionale) shënuan rënie, kryesisht për shkak të alokimit të mjeteve në sektorin e jashtëm.

Grafik 18. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje




Burimi: BQK.

Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë rreth 70.5 përqind të gjithsej depozitave, shënuan rritje vjetore prej 10.4 përqind (16.4 përqind në mars 2021). Ngadalësimi i rritjes së depozitave prej ekonomive familjare krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit

paraprak mund të jetë rezultat i rritjes së nivelit të investimeve kapitale/konsumit. Rritja e investimeve, e veçanërisht në patundshmëri (reflektuar edhe prej rritjes së theksuar të kredive hipotekare), mund të jetë impuls i shkaktuar nga presionet e rritura inflacioniste, pasi që normat e interesit në depozita janë mjaftë të ulëta (rreth 1.0 përqind), ndërsa trendi i çmimeve të patundshmërive është në rritje. Për më tepër, historikisht gjatë tremujorit të parë dhe të dytë, niveli i depozitave është më i ulët krahasuar me tremujorin e tretë (fluksi i remitencave dhe aktivitetit të përgjithshëm ekonomik) dhe të katërt të vitit.

Edhe niveli i depozitave të mbajtura në sektorin bankar prej korporatave jofinanciare shënoi rritje të ngadalësuar krahasuar me periudhën paraprake, prej 13.1 përqind (20.6 përqind në mars 2021) e që reflekton kryesisht presionet inflacioniste prej fillimit të luftës Ukrainë-Rusi, që ka ndikuar në rritje të çmimeve të mallrave esenciale. Bizneset i'u janë kundërpërgjigjur kësaj pasigurie duke rritur rezervat si në kapital të punës po ashtu edhe rritje të stokeve të mallit.

Grafik 19. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Gjatë periudhës janar-mars 2022, vlera e depozitave të reja të arkëtuara⁵ arriti në 93.6 milionë euro, që është

⁵ Depozitat e reja përfshijnë depozitat e afatizuara.

për 9.8 përqind më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 19). Vlera e ulët e depozitave të reja të arkëtuara në vitet e fundit reflekton edhe nivelin e ulët të normave të interesit për depozitat e afatizuara⁶, struktura e të cilave në vitet e fundit është tkurrur kundrejt rritjes së atyre të transferueshme (grafik 20).

Grafik 20. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore



Burimi: BQK.


Depozitat e reja të arkëtuara nga korporatat jofinanciare (depozitat e afatizuara) gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej 19.0 milionë euro, një rënie për 39.9 përqind. Kurse, depozitat e reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare (depozitat e afatizuara), arritën vlerën prej 74.6 milionë euro gjatë kësaj periudhe, që paraqet një rritje vjetore prej 3.5 përqind.

1.3 Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi kanë shënuar rënie graduale ndër vite, duke arritur në nivel të përafërt me vendet e rajonit. Kurse, norma mesatare e interesit në depozita ka mbetur pothuajse e pandryshuar në

vitet e fundit, që kryesisht ka reflektuar nivelin e lartë të likuiditetit të bankave.

Grafik 21. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.

Në mars 2022, norma e interesit në kredi ishte 5.8 përqind kurse ajo për depozita në 1.2 përqind, duke ngushtuar margjinën kredi-depozitë në 4.6 pikë përqindje (grafik 21).


1.3.1 Normat e interesit në kredi

Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare deri në një masë janë më të favorshme krahasuar me ato ndaj ekonomive familjare (grafik 22). Në mars 2022, norma e interesit për kreditë ndaj korporatave jofinanciare qëndroi në 5.7 përqind (6.2 përqind në mars 2021) (grafik 22).

Normat e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve dhe të industrisë janë më të favorshme krahasuar me ato për sektorin e bujqësisë. Normat më të larta të interesit në kredi për sektorin e bujqësisë janë rezultat i rrezikut më të lartë që mbartë ky sektor (grafik 22).

⁶ Norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara në sektorin bankar gjatë periudhës janar-mars 2022 ishte 1.3 përqind.


Grafik 22. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.

Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare vazhduan trendin rënës ngjashëm me ato të korporatave jofinanciare. Norma e interesit për këtë segment në mars 2022 qëndroi në 5.8 përqind.

Grafik 23. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Normë më të favorshme të interesit kishin kreditë hipotekare, që reflekton dhe rritjen e lartë të kredive të reja hipotekare përgjatë kësaj periudhe.

Ndërsa, normat e interesit për kreditë konsumuese ishin më të larta se sa mesatarja e segmentit, por krahasuar me periudhat paraprake, ka po ashtu rënie (grafik 23).

1.3.2 Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të ulëta, me norma lehtësisht më të favorshme për korporatat jofinanciare (1.2 përqind) krahasuar me ato për ekonomitë familjare (1.1 përqind) (grafik 24).

Grafik 24. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.


Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar realizoi fitim në vlerë prej 30.7 milionë euro deri në mars 2022, e që është për 5.0 milionë euro më i lartë krahasuar me gjendjen në fund të marsit 2021 (grafik 25). Fitimi më i lartë i realizuar këtë periudhë reflekton ecurinë e të hyrave (të cilat u rritën për 12.0 përqind), kurse shpenzimet gjatë kësaj periudhe u rritën për 7.9 përqind.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi janë kategoria me peshën më të madhe (72.1 përqind) dhe shënuan rritje vjetore prej 10.4 përqind, rritje kryesisht e atribuar të ardhurave nga interesi në kredi, pasuar nga të hyrat nga plasmanet në bankat dhe institucionet tjera financiare. Të hyrat nga jointerеси që kanë peshë më të ulët në gjithsej të hyrat e sektorit (25.1 përqind) shënuan rritje për 13.8 përqind. Nënkatëgoria e cila shënoi rritjen më të lartë

ishte ajo e tarifave dhe komisioneve, e që reflekton rritjen e kostos për ofrimin e shërbimeve bankare si dhe shfrytëzimin më të lartë të shërbimeve e-banking. Numri i llogarive e-banking është rritur për 30.5 përqind krahasuar me gjendjen në fund të marsit 2021, dhe ka arritur në vlerë prej 567.2 mijë llogari e-banking. Për më tepër edhe sa i përket numrit dhe vlerës të transaksioneve me kartela, ka rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë, për 26.7 përqind dhe 36.0 përqind përkatësisht.

Grafik 25. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Në kuadër të shpenzimeve, kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative që ka peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet (59.4 përqind) shënoi rritje vjetore prej 11.3 përqind gjatë kësaj periudhe. Rritja e konsiderueshme e kësaj kategorie erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve për personelin (rritje të numrit të punëtorëve) dhe shpenzimeve përcjellëse. Ndërsa, kategoria e dytë me peshën më të madhe, ajo e shpenzimeve të jointeresit (22.5 përqind), shënoi rënie vjetore prej 1.6 përqind e që kryesisht reflekton rënien e shpenzimeve për provizionimin nga humbjet e mundshme në kredi.

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ka trashëguar nga vitet e kaluara nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit dhe portofolio me cilësi të lartë kreditore. Kjo ka ndikuar që sektori të ketë kapacitet për të absorbuar krizën e shkaktuar nga pandemia Covid-19 në vitin 2020, duke ruajtur nivel të mirë të treguesve kryesor të shëndetit bankar përgjatë vitit 2021 dhe tremujorit të parë të vitit 2022.

Grafik 26. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione




Burimi: BQK.

Por, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në mars 2022, treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit kanë shënuar ulje, megjithëse vazhdojnë të mbeten dukshëm mbi minimumet e kërkuara rregullative. Për më tepër, sektori bankar ka shënuar përmirësim të portfolios kreditore, duke u zvogëluar si raport (KJP/gjithsej kreditimi) dhe në vlerë.


Niveli i kredive joperformuese në mars 2022 qëndroi në 2.1 përqind, dhe mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme në 152.9 përqind (grafik 26). Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në nivel prej 15.1 përqind, dukshëm mbi nivelin minimal me rregullore prej 12.0 përqind (grafik 27).

Grafik 27. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Grafik 28. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.


Po ashtu, edhe likuiditeti i sektorit qëndroi dukshëm mbi nivelin minimal të rekomanduar prej 25.0 përqind. Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra në mars 2022 qëndroi në nivel prej 31.9 përqind (grafik 28).

Kuti informuese

Bankat me rëndësi sistemike⁷

- Në sektorin bankar, pesë bankat më të mëdha kanë rezultuar me rëndësi të përgjithshme sistemike (grafik 1)


Grafik 1. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike



Burimi: BQK.

Në kriteret e veçanta, bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar të tilla edhe në shumicën e kriterëve përbërës (përjashtuar atë të ndërlidhjes dhe aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit) (grafik 2).

Grafik 2. Shkalla e rëndësisë sistemike, sipas kriterëve



Burimi: BQK.


- Kriteri i ndërlidhjes ka nivelin më të lartë të pikëve sistemike pasi që vetëm tri banka të rëndësisë së përgjithshme sistemike rezultuan të tilla në këtë kriter. Kjo erdhi si rezultat i nivelit të ulët të asetëve/detyrimeve me bankat dhe institucionet tjera financiare dhe ekspozimeve në letrat me vlerë.
- Bankat që nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike, nuk ishin të tilla në asnjërin nga kriteret përbërës.

⁷ Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull 'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.


Kapitali shtesë kundërciklik⁸

- Kalkulimi i kapitalit të nevojshëm shtesë është realizuar sipas udhëzimeve përkatëse nga Komiteti i Bazelit me ç'rast kërkesa për kapital shtesë (në përqindje të asetëve të peshuara me rrezik) është zero atëherë kur hendeku është më i vogël se 2 pikë përqindje, dhe me rritjen e hendekut mbi vlerën 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet mbajtje e kapitalit shtesë deri në nivelin maksimal prej 2.5 përqind.
- Hendeku kredi/BPV ishte nën pragun prej 2.0 pikë përqindje në mars 2022, përkatësisht 0.575 (grafik 3), që nënkupton që sektori bankar nuk ka nevojë të ndaj kapital shtesë ndaj mjeteve të peshuara me rrezik (grafik 4).

Grafik 3. Hendeku i kreditimit



Grafik 4. Kapitali shtesë kundër-ciklik




Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar⁹

- Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar është ndërtuar mbështetur në tregues me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, për matjen dhe vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e

sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.

- Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare, është shënuar rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut në fund të TM1 2022 krahasuar me gjendjen në fund të TM1 2021.
- Vlera e përgjithshme e indeksit në fund të TM1 2022 është nën vlerën mesatare historike të indeksit (grafik 5).

Grafik 5. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar dhe kriterëve përbërës



- Rritja e evidentuar e ndjeshmërisë ndaj rrezikut u ndikua nga indikatorët e solvencës dhe indikatorët e likuiditetit. Kurse, indikatorët e rrezikut kreditor, profitabilitetit, dhe tregut u karakterizuan me ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut.
- Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut në indikatorin e solvencës i atribuohet kryesisht nivelit më të ulët të treguesve të kapitalit (Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit & Kapitalit të Klasit të Parë) krahasuar me gjendjen një vit më parë, e që është rezultat i ndarjes së dividendës në vitin e kaluar me skadimin e masës rekomanduese nga BQK, ndërkohë që kreditimi ka shënuar rritje të shpejtë. Sektori vazhdon të tejkaloj minimumin e rekomanduar të TMK-së prej 12%.
- Rritja e ndjeshmërisë së rrezikut tek indikatorin e likuiditetit ishte kryesisht rezultat i nivelit më të ulët të likuiditetit, shprehur përmes mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (rritje më të ulët të mjeteve likuide kundrejt rritjes më të lartë të detyrimeve afatshkurtra), si dhe ndaj gjithsej asetëve (rritje më të ulët të mjeteve likuide kundrejt total asetëve).
- Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut tek indikatorët e rrezikut kreditor ishte kryesisht rezultat i uljes në vlerë

⁸ Banka për Ndërmjetësimin Ndërkombëtarë (2010). Udhëzimet për autoritetet nacionale që operojnë shtesën e kapitalit kundër-ciklik, Komiteti për Mbikëqyrje Bankare i Bazelit.

⁹ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

dhe nivel të KJP-ve në këtë periudhë krahasuar me gjendjen në fund të TM1 2021.


- Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut tek indikatorit i profitabilitetit iu atribuua fitimit të lartë të realizuar,

ndikuar nga rritja më e lartë e të hyrave të gjeneruara (nga interesi dhe tarifave e komisioneve) kundrejt rritjes së shpenzimeve.

Sektori pensional

Zgjerimi i sektorit pensional rezultoi nga kthimi i lartë në investime të realizuar përgjatë vitit 2021 si dhe kontributet e arkëtuara gjatë tremujorit të parë të vitit 2022. Pushtimi rus në Ukrainë shkaktoi efekte të mëdha negative në tregjet financiare ndërkombëtare, që për pasojë u reflektuan në humbje për sektorin pensional në TM1 2022 dhe kufizuan rritjen e mëtejme të këtij sektori.

Grafik 29. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK.

Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 26.6 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar. Asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 14.0 përqind në mars 2022 dhe arritën vlerën prej 2.34 miliardë euro (grafik 29). Rritja e asetëve kryesisht reflekton rritjen e kontributeve të reja gjatë këtij tremujori; si dhe vlerën e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit të lartë në investime të akumuluar nga periudha TM2-2021 dhe TM4-2021.

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP).

Grafik 30. Struktura e asetëve të FKPK-së (mars 2022)



Burimi: FKPK.


Struktura e asetëve të FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, pesha e të cilave gradualisht është zvogëluar ndër vite kundrejt rritjes së peshës së mjeteve të investuara në vend. Rreth 74.3 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë vendit. Saktësisht, në vlera monetare, rreth 1.73 miliardë euro janë të alokuara në fonde të përbashkëta investuese dhe 1.8 milionë euro janë të investuara në bono të thesarit (grafik 30).

Pjesa e mbetur e mjeteve u investuan brenda vendit, dhe arritën vlerën prej 600.2 milionë euro në fund të marsit 2022. Këto mjete janë kryesisht të investuara në fletë-obligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat në fund të marsit 2022 arritën vlerën

prej 542.5 milionë euro (rritje vjetore prej 17.5 përqind). Vlera e mjeteve të mbajtura në bankat komerciale, në formë të Çertifikatave të Depozitit, u zvogëlua konsiderueshëm, për shkak të orientimit të strategjisë në investime jashtë vendit. Poashtu, mjetet e mbajtura në Bankën Qendrore të Kosovës vazhduan të tkurren, për tu shfrytëzuar në investime, siç janë letrat me vlerë (të Qeverisë së Kosovës) dhe fondet e përbashkëta investuese (jashtë vendit).

Në fund të marsit 2022, vlera e asteteve të FKPK-së arriti në 2.33 miliardë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 14.1 përqind.

Grafik 31. Struktura e aseteve të FSKP-së (mars 2022)




Burimi: FSKP.

Struktura e aseteve të FSKP-së është e ngjashme me atë të FKPK-së, ku rreth 78.0 përqind e tyre janë të investuara jashtë vendit, dhe pjesa e mbetur në Kosovë. Portfolio e FSKP-së përbëhet nga aksionet e investuara jashtë vendit (67.1 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (19.3 përqind), paraja e gatshme (6.4 përqind) dhe instrumentet tjera (7.2 përqind) (grafik 31). Gjithsej asetet e FSKP-së deri në mars 2022 arritën në 9.0 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 2.7 përqind.

Në tremujorin e parë të këtij viti, FSKP-ja kishte kthim bruto negativ nga investimet në vlerë prej 295.8 mijë

euro (+402.9 mijë euro në TM1 2021). Ndërsa, vlera e arkëtimeve të reja nga kontribut-dhënësit në këtë tremujor arriti në 148.3 mijë euro (124.3 mijë euro në TM1 2021). Kthimi negativ nga investimet preku edhe FSKP-në si pasojë e lëkundjeve në tregjet financiare si rezultat i fillimit të luftës në Ukrainë.

Grafik 32. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

Ngjashëm, edhe mjetet e investuara nga FKPK-ja u afektuan nga lufta. FKPK-ja gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 shënoi kthim negativ nga investimet në vlerë prej 60.5 milionë euro (+31.7 milionë euro në TM1 2021) (grafik 32). Ndërsa, kontributet e arkëtuara nga FKPK-ja vazhdojnë të jenë stabile dhe në rritje, ku vetëm gjatë TM1 2022 shënuan vlerën prej 56.0 milionë euro, e që është për 4.1 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë.

Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve u karakterizua me rritje të aktivitetit, përkatësisht rritje të nivelit të primeve të shkruara, e cila u reflektua edhe në gjithsej aktivitetin e sektorit, si dhe rënie të nivelit të dëmeve të paguara që kontribuan në rezultatin pozitiv financiar.

Vlera e gjithsej asetëve (që përfaqësuan 2.8 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar) arriti në 249.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 11.5 përqind. Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, pasuar nga kategoria e rezervave teknike për risiguruesit dhe bilanci i depozitave në bankat komerciale. Kurse, kategoria e investimeve në prona dhe parasë së gatshme dhe depozitave në BQK ishin të vetmet kategori që shënuan rënie krahasuar me gjendjen e një viti më parë.


Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithsej 64.9 përqind, pasuar nga ekuiteti me 25.2 përqind dhe pjesa e mbetur nga detyrimet tjera. Vlera e gjithsej kapitalit të sigurveve gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të theksuar, prej 11.2 përqind. Rritja e kapitalit kundrejt periudhës së njëjtë të një viti më parë i atribuohet kryesisht fitimit të realizuar gjatë periudhës janar-mars 2022 si dhe fitimit të mbajtur nga periudhat e kaluara.

Vlera e primeve të shkruara nga sigurvezit në tremujorin e parë të këtij viti arriti në 29.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.3 përqind (12.6 përqind gjatë periudhës së njëjtë të një viti më parë). Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit “jojetë” të cilat përfaqësojnë 93.7 përqind të gjithsej primeve të shkruara dhe pjesa e mbetur prej 6.3 përqind përfaqësohet nga sigurimi “jetë”.

Rritja e nivelit të primeve të shkruara dhe polisave të shitura krahasuar me vitin e kaluar reflekton ecurinë e shitjeve të polisave të përgjegjësishë ndaj palës së tretë dhe polisave tjera, kurse shitja e polisave kufitare ka shënuar rënie, që është rezultat i vendimit të qeverisë

për mbulimin e plotë të obligimeve të sigurimit kufitar për bashkatdhetarët.


Grafik 33. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e sigurveve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rënie për 0.5 përqind, duke zbritur në vlerën prej 14.7 milionë euro në fund të marsit 2022 (14.8 milionë euro deri në mars të vitit 2021) (grafik 34).

Grafik 34. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 12.3 milionë euro (12.1 milionë euro deri në mars 2021) ishin dëme të paguara nga sigurvezit, ndërsa 2.4 milionë euro (2.7 milionë euro deri në mars 2021) dëme të paguara nga BKS-ja.

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve realizoi rezultat pozitiv financiar prej 386.4 mijë euro¹⁰ në tremujorin e parë të vitit 2022 për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar, që kishte pësuar humbje në vlerë prej 584.2 mijë euro¹¹. Fitimi i realizuar gjatë kësaj periudhe krahasuar me një vit më parë ishte si rezultat i rritjes së nivelit të primeve të shkruara dhe reduktimit të shpenzimeve operative. Ndërsa, rritja e nivelit të dëmeve të ndodhura reduktoi mundësinë e sektorit për të realizuar fitim akoma më të lartë.

Sektori mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar shënoi rritje të theksuar të aktivitetit, e mbështetur nga rritja e përshpejtuar e kreditimit dhe aktivitetit të lizingjeve. Sektori shënoi rezultat pozitiv financiar dhe njëkohësisht ruajti cilësi të lartë të portfolios kreditore.

Asetet

Sektori mikrofinanciar regjistroi rritje vjetore të aseteve prej 12.2 përqind (2.1 përqind rritje vjetore në mars 2021), vlera e të cilave arriti në 355.1 milionë euro. Edhe pse rritja këtë periudhë ishte më e përshpejtuar krahasuar me TM1 2021, gjithsesi nuk arriti nivelet e rritjes së dy viteve para-pandemike, që ishin dukshëm më të larta (grafik 35).

Sektori shënoi rënie të theksuar në zërat e parasë së gatshme dhe bilancit me bankat komerciale, përderisa shënoi rritje dyshifrore në kredi dhe lizingje.

Grafik 35. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Ndryshimet në strukturën e aseteve të sektorit sugjerojnë orientimin e mjeteve drejt rritjes së aktivitetit kreditor. Këto lëvizje në sektorin mikrofinanciar pasqyrojnë rikthimin në normalitet të aktivitetit ekonomik në vend me lehtësimin emasave kufizuese, procesit të vaksinimit të popullsisë, ardhjes së diasporës dhe rritjes së remitencave.

Kreditë


Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar për 19.0 përqind në mars 2022, përderisa stoku i tyre arriti në 248.7 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy segmentët ekonomik, korporatat jo-financiare dhe ekonomitë familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 17.1 përqind (3.4 përqind rënie vjetore në mars 2021), duke arritur vlerën 161.2 milionë euro në fund të marsit 2022 (grafik 36).

Stoku i kredive ndaj korporatave jo-financiare arriti vlerën prej 87.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 22.5 përqind (rënie vjetore prej 2.7 përqind në mars 2021).

¹⁰ Larguar fitimi/humja neto e kompanive të sigurimit Insig & Kosova e Re (të bartuar pas marrjes së licensës)

¹¹ Larguar fitimi/humja e kompanisë së sigurimit insig (të barutur pas marrjes së licensës)


Grafik 36. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.

Kreditimi ndaj sektorëve të ekonomisë shënoi rritje të përshpejtuar. Rritjen më të lartë e shënoi sektori i shërbimeve financiare, pasuar nga sektori i tregtisë dhe i bujqësisë (grafik 37).

Grafik 37. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Lizingjet

Lizingjet vazhduan trendin rritës, edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me ritmin e rritjes para pandemisë. Aktiviteti i lizingut shënoi rritje vjetore prej 15.4 përqind (6.3 përqind në mars 2021), duke arritur vlerën prej 66.5 milionë euro në fund të marsit 2022.

Kjo rritje kryesisht reflekton lizingun ndaj korporatave jo-financiare, vlera e të cilit arriti në 39.5 milionë euro e që paraqet rritje vjetore prej 24.2 përqind (grafik 38).

Grafik 38. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Lizingu ndaj ekonomive familjare kishte rritje të ngadalësuar krahasuar me atë të korporatave jofinanciare, duke shënuar rritje vjetore prej 4.6 përqind (3.3 përqind në mars 2021), përderisa vlera e përgjithshme e tyre në mars 2022 arriti në 27.0 milionë euro.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në mars 2022 ishte 18.9 përqind, për 1.2 pikë përqindje më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 39).

Grafik 39. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi ulje për 0.3 pikë përqindje, në 20.8 përqind

(grafik 39). Sipas llojit të kredive, për kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit u ulë ndjeshëm, për 3.6 pikë përqindje në 16.4 përqind. Kurse, për kreditë konsumuese, norma e interesit u zvogëluar për 0.5 pikë përqindje, në 22.6 përqind.

Grafik 40. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK.

Për korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar për 2.4 pikë përqindje, në 16.0 përqind. Sipas sektorëve ekonomik, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për sektorin e shërbimeve, pasuar nga kreditë për sektorin e bujqësisë me normë interesi 13.7 përqind dhe 18.9 përqind, respektivisht (grafik 40).

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar në tremujorin e parë të vitit 2022 realizoi fitim neto në vlerë prej 4.1 milionë euro, kundrejt fitimit prej 2.9 milionë euro të realizuar një vit më parë. Ky fitim ishte më i larti i realizuar përgjatë tremujorëve të parë, që nga konsolidimi i sektorit.

Grafik 41. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Të hyrat e sektorit deri në mars 2022 shënuan vlerën prej 13.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 16.4 përqind. Rritja kryesisht i'u atribuua rritjes së të hyrave nga interesi në kredi dhe në lizingje, përderisa të ardhurat nga jo-interesi shënuan rritje më të ngadalësuar (grafik 41).

Shpenzimet e sektorit shënuan rritje vjetore prej 8.0 përqind dhe arritën vlerën në 9.0 milionë euro në fund të tremujorit të parë 2022.

Rrita e shpenzimeve kryesisht reflektoi ecurinë e shpenzimeve tjera operative dhe atyre nga jo-interesi. Kurse, shpenzimet për interesa deri në mars 2022 u zvogëluar pavarësisht rritjes së nivelit të huazimeve nga sektori i jashtëm.

Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së sektorit, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim, duke u zvogëluar për 5.3 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, në nivelin prej 68.9 përqind në mars 2022.


Grafik 42. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rritje, në 5.1 përqind dhe 19.6 përqind nga 3.9 përqind dhe 17.0 përqind respektivisht në mars 2021 (grafik 42).

Grafik 43. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK.

Sa i përket treguesve të cilësisë së portofolios kreditore, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe kishin mbulueshmëri të lartë me provizione. Në mars 2022 kreditë jo-performuese zbritën në 2.3 përqind nga 3.0 përqind sa ishin në mars 2021. Ndërsa, mbulueshmëria e KJP-ve me provizione arriti në 143.5 përqind nga 145.8 përqind në mars të vitit të kaluar (grafik 43).

Tregu i letrave me vlerë

Në tremujorin e parë të vitit 2022, Qeveria e Kosovës realizoi tri ankande të emetimit të letrave me vlerë duke emetuar borxh në vlerë më të ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2021. Kërkesa për investim në këto ankande vazhdon të tejkaloj ofertën e qeverisë.

Grafik 44. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave.

Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës në tremujorin e parë të vitit 2022 shënoi rënie vjetore prej 29.6 përqind krahasuar me vitin paraprak, duke rezultuar në vlerën prej 59.8 milionë euro (grafik 44).

Mungesa e tregut të kapitalit në vend, si dhe mundësitë e kufizuara për investime alternative të mjeteve, pasqyrohet në kërkesën për letra me vlerë të Qeverisë që vazhdimisht tejkalon ofertën përkatëse. Më konkretisht, kërkesa për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.26 herë më e lartë se sa shuma e ofruar (2.18 herë më e lartë një vit më parë). Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 ishte 2.7 përqind, që paraqet një rritje për 1.0 pikë përqindje krahasuar me normën mesatare në TM1 2021 (grafik 45).

Grafik 45. Shuma e ofruar dhe e emetuar




Burimi: Ministria e Financave.

Struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitet prej 3 vite, pasuar nga ato me maturitet prej 5 dhe 7 vite (grafik 46). Vlen të cekët, që në këtë periudhë, për të tretin vit me radhë, Qeveria e Kosovës nuk ka emetuar bono të thesarit, duke u fokusuar vetëm në fletëobligacionet qeveritare me maturitet më afatgjatë.

Fondet pensionale, sektori bankar, institucionet publike dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë institucionet investuese në tregun primar të letrave me

vlerë të Qeverisë së Kosovës. Sektori pensional vazhdon të jetë më i ekspozuari ndaj qeverisë me rreth 62.3 përqind të gjithsej stokut të borxhit të brendshëm. Sektori bankar ka ekspozim me rreth 32.7 përqind të gjithsej stokut të borxhit të brendshëm dhe pjesa e mbetur e borxhit të qeverisë mbahet nga sektori i sigurimeve (5.1 përqind).

Grafik 46. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje




Burimi: Ministria e Financave.

Appendix: çmimet e importit të produkteve esenciale


Çmimi nuk përfshinë taksat e zhdoganimit të mallit (TVSH, Akcizë, Taksa doganore) si dhe kostot tjera relevante.

Grafik 1. Çmimi i energjisë elektrike për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 2. Çmimi për gaz propan të lëngshëm, për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 3. Çmimi i karburantit (gazoil-naftë) për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 4. Çmimi i benzinës për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 5. Çmimi i grurit, për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 6. Çmimi i orizit për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 7. Çmimi i misrit për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 8. Çmimi për vezë, për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 9. Çmimi i qumështit për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 11. Çmimi i mishit të gjedhit të freskët, për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 10. Çmimi i djathit dhe gjizës, për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 12. Çmimi i mishit të gjedhit të ngrirë, për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 13. Çmimi i patates për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 14. Çmimi i domates për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 15. Çmimi i vajit të luliediellit për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 16. Çmimi i sheqerit të bardhë për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 17. Çmimi i bananes për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 18. Çmimi i peletit për ngrohje, për njësi, mesatarja tremujore




Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 19. Çmimi i kafes për njësi, mesatarja tremujore



Burimi: Dogana e Kosovës.

Grafik 20. Çmimi i çajit për njësi, mesatarja tremujore



Burimi: Dogana e Kosovës.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 38, TM1 2022, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://ëëë.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

Bloomberg: Metal Prices database: [Commodities - Bloomberg](https://www.bloomberg.com/professional/data/commodities/)

FAOUN: World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:
<http://ëëë.fao.org/ëorlfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF: World Economic Outlook: World Economic Outlook (imf.org)

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Mars 2021	Mars 2022
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	1,581.6	1,740.7
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.6%	8.2%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.2%	10.0%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	454.9	542.6
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	487.5	428.1
Bilanci primar (në milionë euro)	-32.6	114.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	8,066.6	8,797.2
prej të cilave: Bankat	5,449.4	5,824.2
Kredi	3,320.8	3,930.5
Depozita	4,422.9	4,745.8
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.1%	5.8%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.4%	1.2%
Hendeku i normës së interesit	4.7%	4.6%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-152.1	-344.6
prej të cilave: remitencat e pranuar	242.9	241.2
Llogaria financiare	-93.8	-307.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	103.8	147.4
Investimet portfolio, net	94.2	-52.5
Investimet tjera, net	-4.2	-174.6
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-829.6	-935.6
Asetet	5,315.6	6,082.2
Detyrimet	6,145.2	7,017.9
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,517.0	2,977.2
Borxhi i jashtëm privat	1,901.3	2,206.3
Borxhi i jashtëm publik	615.8	770.9

Burimi:

1/ ASK

2/ MF

3/ BQK

*Të dhënat për PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në dhjetor 2021.

